

**PKR.nr. 1048/13**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA** – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri- kryetare e trupit dhe anëtarëve të trupit gjykues-gjyqtarët Mustafë Tahiri dhe Isuf Makolli, me bashkëpunëtorin profesional Driton Berisha, në lëndën penale kundër të akuzuarve S.H., B.H., F.B., B.Sh., A.I., A.Zh.për shkak të veprës penale Mashtrim në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për krime të rënda PP.I.nr.90A/2013, të dt:11.11.2013, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë e publik, në prezencë të prokurorit të shtetit Ilaz Beqiri, të akuzuarve S.H., B.H., F.B., B.Sh., A.I., A.Zh., me dt: 17.07.2018, mori dhe publikisht shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

Kundër të akuzuarëve:

**S.H.** nga i ati K. dhe e ema A.1 i vajzerise S.1, i lindur me ... në P.1, tani me vendbanim në fsh. “S. e m.” KK-F.K., ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar në aeroport si udhëheqës I ndrrimit mirmbajtjen e pistës, i martuar baba i ... fëmijëve, më parë jo i gjykuar. gjendjes të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**B.H.** nga i ati A.2 dhe e ema F. i vajzerise Sh.1, i lindur me ... në fsh C., KK-M., tani me vendbanim në f.sh. “S. e M.” KK-F.K., ka të kryer shkollën e mesme – xehtari, i punësuar në K.1, i martuar, baba i ... fëmijëve, gjendjes të dobët ekonomike, më parë jo i gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**F.B.** nga i ati R. dhe e ema H.1 i vajzerise P.2 , i lindur me ... në fsh G. i u. KK- F.K., tani me vendbanim F.K. r. D. bllok ... kati i ..., ka të kryer fakultetin e kulturës fizike dhe spoteve, i punësuar në K.2 në F.K. zyrtar për rini dhe sport, i martuar, baba i ... fëmijëve, më parë jo i gjykuar, gjendjes të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**B.SH.** nga i ati Sh.2 dhe e ëma S.2, i vajzerise Sh.3, i lindur me ... nga f.sh “H.2” KK-F.K., ku dhe tani jeton, ka të kryer shkollën fillore dhe dy vite të shkollës së mesme, i punësuar si punëtor teknik në shkollën “B.C.” në fsh.H.2, i martuar, baba i ... fëmijëve, gjendjes së varfër ekonomike, më parë jo i gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**A.I.** nga i ati B. dhe e ëma N. i vajzerise Gj., i lindur me ... nga f.sh S. e m. Kk-F.K. ku dhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, tani studente në fakultetin juridik në vitin e ..., e pa martuar, gjendjes së dobët ekonomike, më parë jo e gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**A.ZH.**nga i ati M.1 dhe e ëma M.2 i vajzerise I., i lindur me ... nga B. I m. KK-F.K. , ka të kryer shkollën e mesme - teknike, studente e fakultetin Filozofik në vitin e ..., e pa martuar, më parë jo e gjykuar, gjendjes të dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **LIROHEN NGA AKUZA**

**SEPSE;** me datën: 12.10.2010, në qendrën e votimeve 0903E/03R e cila gjendet në shkollën B.C., në fshatin S. e M.- Komuna e F.K., gjatë ditës së votimeve të pandehurit në cilësinë e anëtarëve të këshillit të vendvotimeve, në bazë të marrëveshjes paraprake, me qëllim të ndryshimit të rezultateve të zgjedhjeve, kanë falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve për Kuvend të Republikës së Kosovës, në atë mënyrë që nga kandidatët e ndryshëm Brenda për Brenda një subjekti politik kanë marrë 748 vota dhe të njëjtat u; a kanë numëruar kandidatëve të preferuar të tyre, me ç’rast buxhetit të Kosovës i kanë shkaktuar dëm të konsiderueshëm material,-

-Me këtë kishin për të kryer veprën penale Mashtrim në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së,

Për të akuzuarit S.H., B.H., F.B., B.Sh., A.I., A.Zh.shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda, ka ngritur aktakuzë PP. I.nr 90A/2013 të dt:11.11.2013, kundër të akuzuarëve: S.H., B.H., F.B., J.L., B.Sh., A.I., A.Zh.për shkak të veprës penale Mashtrim në votime nga neni 180 lidhur me nenin 23 të KPK-së.

Në këtë çështje penale gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor, dhe pasiqë të akuzuarit janë njoftuar me të drejtat e tyre në kuptim të nenit 323

par.1 dhe 2 të KPPRK-së, janë deklaruar të pafajshëm lidhur me veprat penale për kryerjen e të cilavë janë akuzuar. Andaj, meqenëse të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë lidhur me këto vepra penale, Gjykata duke u bazuar në nenin 327 të KPPRK-së, ka vendosur që seanca e shqyrtimit gjyqësor të vazhdojë me fjalën hyrëse dhe prezantimin e provave.

Prokurori i shtetit Ilaz Beqiri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga të gjitha provat e administruara është vërtetuar gjendja faktike sin ë dispozitiv të aktakuzës dhe atë nga dëshmia e dëshmitarit, njëherit përfaqësuesi i KQZ-së i cili ka përshkruar procedurat dhe rregullat e procesit të votimit dhe pastaj numrimit të votave, raporti i auditimit nga i cili vërtetohet se nga tani të akuzuarit janë manipuluar 748 vota ashtu që të njëjtat i janë bartur kandidatëve të tyre të preferuar. Andaj, nga gjykata ka kërkuar që të njejtin t'i shpall fajtorë dhe t'i dënojë në përputhje me ligjin.

Përfaqësuesi i KQZ-së në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e përkras fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe nuk paraqet kërkesë pasurore-juridike

I akuzuari S.H., në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtimin gjyqësor dhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka qenë k. i vendvotimit në Qendrën e vendvotimit në fshatin S. e M. ndërsa që antarët e komisionit kanë qenë tani bashkakuzuarit dhe se në ditën e zhvillimit të votimeve i gjithë procesi ka shkuar në rregull, përfshirë edhe procesin e numrimit të votave dhe se nuk ka pasur kurrfarë mundësie që një kandidati t'i shënohen më shumë vota sesa që është votuar për të njëjtin dhe kjo pasi që gjatë procesit të numrimit të votave të pranishëm janë edhe vëzhguesit e subjekteve të ndryshme politike, ndërsa që pas përfundimit të procesit të numërimit, një nga fletët ku shkruhet numri i votave të fituara nga secili kandidat, vendoset në derën e vendvotimit ku mund të shihet nga të gjithë të interesuarit. Po ashtu i akuzuari ka sqaruar se procesi i numërimit zhvillohet në atë mënyrë që një nga antarët e komisionit e tërheq fletëvotimin, e kontrollon vet, pastaj të njëjtën u'a tregon edhe antarëve të tjerë të komisionit, të cilët e shiqojnë atë fletëvotim, përfshirë edhe vëzhguesit të cilët janë të pranishëm në momentin e numrimit të votave, pastaj janë evidentuar në formular nga vet i akuzuari S.3, ndërsa që pas përfundimit të procesit të numërimit, fletëvotimet vendosen në kutinë e fletvotimeve në prezencë të antarëve të komisionit dhe të njëjtat transportohen në KKZ, të shoqëruar edhe nga policia e cila bën sigurimin e transportimit të tyre. Ndërkaq që në fjalën përfundimtare po ashtu ka përsëritur pretendimin se i gjithë procesi i votimit dhe numërimit ka shkuar në rregull. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të njejtin t'a shpall të pafajshëm dhe ta lirojë nga akuza.

I akuzuari B.H. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka qenë antarë i komisionit në vendvotimin në qendren e votimit në fshatin S. e M. dhe se gjatë procesit të votimit detyra e tij ka qenë vulosja e vendvotimeve dhe shpërndarja e tyre dhe se pas mbylljësë qendrës së votimit ka filluar procedi i numërimit, e gjatë të cilit process kanë qenë të pranishëm përvec antarëve të komisionit edhe vëzhguesit nga partitë e ndryshme politike, ndërsa që ky ka bërë leximin e votave, ndërsa që kryesuesi i vendvotimit i ka evidentuar të njëjtat dhe gjatë procesit të numërimit nuk ka pasur ankesa për parregullësi gjatë këtij procesi. Ndërsa që në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ndjen vetën fajtor për kryerjen e vepres për të cilën është akuzuar, andaj ka kërkuar nga gjykata që ta shpall të pafajshëm.

I akuzuari F.B. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka qenë në cilësinë e k. në zgjedhjet nacionale të vitit 2010 në qendrën e votimit 0903E/03R, në shkollën fillore B.C. në fshatin S. e M., dhe se i gjithë procesi i votimit e pastaj numërimit ka shkuar në rregull dhe se me rastin e numërimit të votave në cilësinë e kryesuesit ka qenë kryesuesi, tani i akuzuari S.H., ndërsa që ai ve ka bërë leximin e fletave të votimit. Po ashtu edhe ky i akuzuar ka shpjeguar procedurat e numërimit të votave ku ka theksuar se në përfunim të procesit të numërimit, në një rën nga fletët ku janë të evidentuara rezultatet e votimeve vendoset në derën e klasës ku edhe ka ndodhur numërimi i votave, ndërsa që gjatë gjithë procesit të votimit, vëzhgues janë edhe përfaqësuesit e subjekteve politike të cilët monitorojnë të gjithë procesin e numërimit të votave. Po ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka pretenduar se procesi i votimit dhe numërimit ka shkuar në rregull dhe nga gjykata ka kërkuar që të njëjtin ta lirojë nga akuza.

I akuzuari B.Sh. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka qenë k. në qendrën e votimit 0903E/03R në shkollën fillore “B.C.” në fshatin S. e M. dhe se detyra e tij ka qenë verifikimi i votuesve me llambën ultraviolett dhe se i gjithë procesi i votimit që është mbyllur në orën 19:00 ka shkuar në mënyrë të rregullt dhe po ashtu edhe procesi i numërimit i cili ka zgjatur derei në ora 24:00, po ashtu ka shkuar në mënyrë ktrejt të rregullt dhe se gjatë procesit të votimit prezent kanë qenë edhe vëzhguesit të ndryshëm të cilët e kanë përcjellur të gjithë procesin, ndërsa që nuk i kujtohet se në fund të procesit të numërimit është nënshkruar në ndonjë document, ndërsa që pas të ofrimit në vështrim të rezultatetve të kandidatëve, ka pohuar se nënshkrimi në të njëjtën është i tij. Në fjalën përfundimtare po ashtu ka

deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor dhe nga gjykata që ta lirojë nga akuza për veprën penale përkryerjen e të cilës është akuzuar.

E akuzuara A.I. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka qenë në cilësinë e k. në zgjedhjet nacionale të vitit 2010, në qendrën e votimeve në shkollën “B.C.” në fshatin S. e M., dhe se detyra e saj konkrete ka qenë verifikimi i personave në regjistrin e votuesve në librin e votimeve dhe se me rastin e numërimit të votave pas mbylljes së procesit të votimit dhe fillimi i procesit të numërimit, detyra e saj ka qenë leximi i fletvotimeve dhe se nuk i është kujtuar nëse është nënshkruar dikund. Në fjalën përfundimtare po ashtu ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor dhe nga gjykata që ta lirojë nga akuza për veprën penale përkryerjen e të cilës është akuzuar.

E akuzuara A.Zh. në mbrojtjen e paraqitur në shqyrtim gjyqësor dhe në deklaratat e dhëna në procedurën paraprake ka deklaruar se ka qenë në cilësinë e komisionerës në qendër të votimit 0903E/03R, në shkollën “B.C.” në fshatin S. e M., dhe ka pasur për detyrë spërkatjen e gishtërinjëve të votuesve. Në këtë detyrë ka qenë e caktuar nga një OJQ. Më tutje ka shtuar se pas mbylljes së vendvotimit ka filluar procesi i numërimit ku ka pasur për detyrë leximin e votave, po ashtu gjatë gjithë numërimit kanë qenë të pranishëm të gjithë antarët e komisionit dhe pas përfundimit të tij, janë nënshkruar. Në fjalën përfundimtare po ashtu ka deklaruar se nuk e ndien vetën fajtor dhe nga gjykata që ta lirojë nga akuza për veprën penale përkryerjen e të cilës është akuzuar.

Lidhur me këtë çështje penale, gjykata ka proceduar dhe administruar të gjitha provat personale dhe materiale të propozuara nga palët në procedurë, dhe atë dëshmitë e dëshmitarëve L.B. dhe Sh.K., si dhe provat materiale: Raporti i auditimit i dt:16.12.2010 dhe i dt:03.01.2011.

Dëshmitari L.B. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar që ditë e zhvillimi të procesit të votimit ka qenë në cilësinë e vëzhguesit i angazhuar nga organizata Demokracia në veprim në fshatin “S.4” dhe se detyra e tij ka qenë që të monitorojë zhvillimin e procesit të numërimit të votave dhe ka qenë në atë qendër votimi deri s aka përfunduar i gjithë procesi i numërimit dhe se më konkretisht ka qëndruar afër tani të akuzuarit F.B. i cili ka bërë leximin e fletvotimeve dhe se nuk ka vërejtur asnjë parregullësi gjatë atij procesi, dhe se personat tani të akuzuar janë pikërisht ata persona të cilët kanë bërë edhe numërimin e fletëvotimeve dhe se në ato kushte nuk ka pasur asnjë mundësi objektive që të bëhet ndryshimi i votave ashtu që votat nga një kandidat ti evidentohen kandidatit tjetër, duke qenë se edhe ai vet në cilësinë e vëzhguesit ka bërë verifikimin e procesit.

Dëshmitari Sh.K. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se po ashtu ka qenë në cilësinë e vëzhguesit në qendrën e votimit në shkollën fillore "B.C." në fshatin S. e M. " dhe se detyra e tij ka konsistuar në vëzhgimin e punës së komisionërëve gjatë procesit të votimit dhe numërimit të votave dhe se gjatë këtij procesi ky dëshmitar nuk ka vërejtur asnjë parregullësi dhe se gjatë procesit të numërimit të votave nga personi i cili ka bërë leximin e fletëvotimeve, tani i akuzuari F.B., është bërë prezentimi i fletëvotimit me c'rast të njëjtin kanë mundur ta shohin të gjithë të pranishmit të cilët edhe kanë mbajtur shënime, ndërsa që ka deklaruar se nuk e dinë se kush ka mundur të bëjë ndryshime në numrin e votave në numrin e votave të evidentuara për kandidatë, në formularin për rezultatin e kandidatëve

Nga raporti i auditimit i dt.16.12.2010, Komisionit Qendror Zgjedhor lidhur me vendvotimin 0903E/03 vërtetohet se i njëjti është përpiluar nga një person me emrin F.H., pastaj është evidentuar se fjala është për zgjedhje për Kuvend të Kosovës, ndërsa që në rubrikën "Përshkrimi i rastit" janë evidentuar inicialet LDK dhe disa numra  $181 \times 5 = 905$ , kandidatë 917, diferenca 12. Po ashtu nga raporti i auditimit 03.01.2011 i Komisionit Qendror Zgjedhor lidhur me vendvotimin 0903E/03, vërtetohet se i njëjti është përpiluar nga V.A. dhe se në të njëjtën po ashtu në rubrikën "Përshkrimi i rastit" janë evidentuar inicialet e partive politike pa dhënë shpjegime të mëtejshme.

Gjykata ka vlerësuar edhe dëshmitë e dëshmitarve L.B. dhe Sh.K., dhe të cilat dëshmi i ka gjetur si dëshmi të sigjerta, reale, objektive e nga të cilat dëshmi vërtetohet bindshëm fakti se tani të akuzuarit në cilësinë e k. në qendër të votimit 0903E/03R, në shkollën "B.C." në fshatin S. e M., kanë vepruar në pajtim me rregullat dhe standardet përkatëse gjatë gjithë procesit të votimit e pastaj të numërimit të votave, ashtu që rezultatin e votimeve e kanë pasqyruar në mënyrë të saktë dhe të plotë në formularin e rezultateve për kandidatë.

Gjykata ka vlerësuar edhe këtë provë materiale dhe si e tillë ka gjetur se të njëjtat nuk qëndrojnë në nivelin e provave të artikulueshme duke qenë se në vete nuk përmbajnë elemente të domosdoshme të raporteve në fushën e auditimit, duke qenë se përveç evidentimit të disa inicialeve dhe numrave nuk ipen kurfarë sqarime të mëtejme lidhur me qënien e tyre aty pra pse janë shënuar të njëjtit dhe nëse kemi të bëjmë me konkluzione apo përfundime të një procesi që në këto raporte nuk ka asnjë të dhënë të besueshme se vërtetë ka ndodhur një raport auditimi. Andaj, gjykata vlerëson se nga kjo provë nuk mund të vërtetohet gjendja faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqenëse nuk është provuar se të akuzuarit S.H., B.H., F.B., J.L., B.Sh., A.I., A.Zh.kanë kryer veprën penale Mashtrim në votime nga neni 180

lidhur me nenin 23 të KPK-së, gjykata konform nenit 364 paragraf 1 nënparagraf 1.3 të KPPRK-së e ka liruar ka aktakuza.

Në bazë të nenit 454 paragraf 1 të KPPRK-së është vendosë që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore.

Nga se u cek me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**  
**PKR.nr .1048/13 të dt. 17.07.2017**

**Bashkëpunwtori profesional**  
**Driton Berisha**

**Kryetarja e trupit - gjyqtarja,**  
**Shadije Gërguri**

**KESHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate